



# **QENDRA HISTORIKE E PRISHTINËS**

## **NUMËRON DITËT E FUNDIT**

Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe  
**EC MA NDRYSHE**  
TETOR, 2014

**RAPORT HULUMTIMI**  
**Qendra Historike e Prishtinës numëron ditët e fundit**  
Autore: Flaka Xërxa, arkitekte

**Hyrje**

**I.Përmbledhje ekzekutive**

**II.Historiku i bërthamës së qytetit**

*Venitja e Prishtinës së dikurshme*

**III.Rëndësia e Qendrës Historike**

*Aty ku zë fill një qytet*

**IV.Gjendja aktuale**

*Qendra e 'pa dukshme'*

**V.Zhvillimet nga viti 1978**

*Kufijtë e lëvizshëm*

**VI. Kaosi i ndërmjetëm**

*Boshësi veprimesh insitucionale, aktivitet i shtuar ndërtimor*

**VII.Problematikat**

*Aty ku fillon dhe s'perfundon përgjegjësia*

**IX.Rekomandimet**

*Më keq se asnjherë, më vonë se kurrë*

**Referencat**

**EC Ma Ndryshe**

*Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit "Transparenca online e komunës së Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës", i përkrahur financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë*



British Embassy  
Pristina

## Hyrje

Qendra Historike e Prishtinës dhe monumentet e saj janë në shkallë të lartë të rrezikshmërisë. Shkatërrimi nga faktori njeri vazhdon çdo ditë. Institucionet përgjegjëse lënë të kuptojnë se kanë zgjedhur heshtjen si formë mos-veprimi. Ky raport është një thirrje për veprim sa më të shpejt. Degradimi i bërtamës historike është duke vazhduar me të madhe, duke alarmuar se për ruajtjen e tipareve dalluse të dikurshme të saj kanë mbetur figurativisht edhe pak minuta kohë. Padyshim se kërkohet një vullnet për mobilizim për shpëtimin e asaj që ka mbetur.

Në bërtamën e Prishtinës, gjendja rezulton të jetë alarmante. Zona Historike e dikurshme u emërua herë Qendër Historike e herë Qytet i Vjetër<sup>1</sup>. Por pavarësisht risive në emërtime, qasja për trajtimin e saj nuk rezultoi të jetë e ndryshme, e aq më tepër e qëlluar. Ky raport sjell në pah të dhëna historike lidhur me bërtamën e qytetit, mënyrën se si u trajtua ajo ligjërisht e në raport me planifikimin urban. Kufijtë e lëvizshëm të saj dhe statusin që ajo gëzon momentalisht. Raporti në mes tjerash nxjerr si problematika kryesore: mungesën e bashkëveprimit ndër-institucional, mungesën e kufijve të definuar të zonës, mungesën e statusit ligjor të zonës, statusin e përkohshëm të dhënë për objektet<sup>2</sup> në mbrojtje si dhe aktivitetin ndërtimor brenda zonës.

Mos përmbushja e obligimeve ndaj trashëgimisë kulturore sot shihet kudo në mjediset urbane, por edhe rurale. Veçanërisht qytetet janë sulmuar me ndërtime të pakontrolluara dhe shkatërrime të vazhdueshme të vlerave të trashëgimisë arkitekturale. Urbanizmi kaotik ka gllabëruar qendrat urbane të Kosovës. Për këtë përgjegjësia fillon nga institucionet përgjegjëse për shkatërrimin e pamëshirshëm të asaj që na takon të gjithëve, ndërsa nga kjo përgjegjësi nuk duhet amnistuar as qytetarët.

Udhëzuesi për Trashëgiminë Kulturore definon disa nga kriteret themelore lidhur me rëndësinë e trashëgimisë kulturore, si: rëndësia historike dhe estetike, rëndësia shkencore dhe hulumtuese si dhe rëndësia shpirtërore dhe shoqërore.<sup>3</sup> Por, pavarësisht shtresimit të shumëfishtë të rëndësisë së saj, trashëgimia kulturore mbetet jashtë prioritetëve të shoqërisë sonë. Ajo për më tepër

1.Përgjatë këtij raporti, përdoren dy terme për t'iu referuar bërtamës historike të qytetit. Me "Zonë Historike" nënkuptohet bërtama historike e definuar sipas Planit Urbanistik Detal të vitit 1978, ndërsa me "Qendër Historike" nënkuptohet bërtama historike e definuar sipas Planit Strategjik të Zhvillimit Urban të Prishtinës, i vitit 2001

2.Në këtë raport, termi "objekt" i referohet trashëgimisë ndërtimore që gëzon mbrojtje ligjore, ose ka potencial për ta fituar këtë status.

3."Udhëzues për Trashëgiminë Kulturore", dokument i prodhuar brenda kornizës së projektit "BE/KE-Përkrahje për Promovimin e Diversitetit Kulturor në Kosovë", 2012

është duke u përdorur si instrument për qëndrime të ndryshme politike, promovim të ideologjive fetare, keqpërdorim të parasë publike dhe arritje të interesave personale apo të grupeve të caktuara. Qendra Historike e Prishtinës nuk përbën përjashtim, e për më tepër mund të konsiderohet si njëra nga rastet më të rënda të degradimit në Kosovë. Ky raport flet për ditët e fundit të Qendrës Historike të Prishtinës dhe e artikulon thirrjen e fundit për të shpëtuar atë që ka mbetur nga kjo zonë.

Të intervistuarit, përfaqësuesit e institucioneve dhe bashkëpunëtorët e tjerë në përpilimin e këtij raporti, kanë folur me entuziazëm se si Qendra Historike e Prishtinës do të mund të rivitalizohet në formën më të mirë të mundshme. Qytetarët e vjetër të cilët i kemi takuar kanë kujtuar me nostalgji rugët e dikurshme e dyqanet e një kohe. Por pa u dorëzuar në idenë se këtë përjetim ua ka marrë dikush përgjithmonë. Ne besojmë bashkë me ta se Prishtinën e vjetër nuk mund ta marrë askush nga ne. Ajo ekziston në kujtimet e secilit, qofshin ato edhe fiktive. Për hir të kujtesës kolektive, nevojitet një mobilizim i përgjithshëm dhe sa më i shpejtë, madje duke shfrytëzuar edhe mësimet e këqija nga zhvillimet e viteve të fundit.

## I.Përmbledhje ekzekutive

Trashëgimia kulturore mbetet ndër kapitujt pothuajse të venitur të kujtesës sonë. Vlerat e patjetërsueshme dhe të trashëguara ndër breza i janë nënshtruar shkatërrimit, proces në të cilin akterët rëndom janë të pa ndëshkuar. Tashmë është i harruar fakti se trashëgimia kulturore është e të gjithëve dhe si vlerë duhet të ruhet nga të gjithë, me obligimin parësor që t'i përcillet brezave të ardhshëm. Në këtë mënyrë, theksi nuk bie vetëm te ruajtja e vlerave të trashëgimisë, por njëherit te përkushtimi për ngritjen e një sistemi të vlerave, i cili do të kishte ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e mjedisit urban, ngritjen e kapaciteteve për investime ekonomike, zhvillim social dhe kulturor.

Nocionet mbi trashëgimisë kulturore të definuara në Ligjin për Trashëgiminë Kulturore, përkatësisht trashëgimia arkitekturale, trashëgimia arkeologjike, trashëgimia e luajtshme dhe ajo shpirtërore mbeten përgjithësisht të ngujuara në letër, si pjesë e një dokumentacioni, i cili nuk u jetësua për qëllimin parimor të tij: njohjen, promovimin dhe ruajtjen e vlerave.<sup>4</sup>

## Për fatin më të keq Ligji për Trashëgiminë


4.Ligji për Trashëgiminë Kulturore është miratuar në vitin 2008, në bazë të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, dhe është në shfrytëzim deri në aprovimin e Ligjit të ri për Trashëgiminë Kulturore.



*Kjo ishte qendra e dikurshme e Prishtinës, e karakterizuar me përqëndrimin e përmbajtjeve publike të cilat rrethoheshin me objektet e banimit. Dominonin kupollat dhe vertikalet e objekteve të religjionit, minaretet.*



*Struktura e dikurshme e qytetit oriental ishte e konceptuar ne rrugët e ngushta të cilat gruponin shtëpitë individuale duke formuar kompozicione 'mahallash'.*



*Në Qendrën Historike të Prishtinës u aplikuan metodologji shkatërruese dhe degraduese, duke filluar nga misioni për të sjellur modernen nën moton "Ta rrënojmë të vjetrën, ta ndërtojmë të renë".*

Kulturore, Ligji për Planifikimin Hapësinor, si dhe Politika e Konservimit të Integruar të Trashëgimisë Kulturore si pjesë e legjislacionit, nuk kanë ndihmuar aspak të forcimin e bashkëveprimit ndër-institucional. "Në nivelin qendror, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor i kanë hartuar dhe miratuar të gjitha ligjet dhe politikat e rëndësishme pa e involvuar njëra-tjetrën".<sup>5</sup>

Se zhvillimet kanë shkuar për të keq, flasin edhe qasje të tjera të gabuara në lidhje me vlerësimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në përgjithësi dhe asaj arkitekture në veçanti. Bazuar në Konventën për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkitekturore të Evropës, palët të implikuara në marrjen e masave mbrojtëse janë të obliguara që të përfshijnë mbrojtjen e trashëgimisë arkitekture si objektiv kyç në planifikimin urban dhe rural, të avansojnë programet për restaurimin dhe ruajtjen e trashëgimisë arkitekture, të mundësojnë që ruajtja, avansimi dhe përmirësimi i trashëgimisë të jetë karakteristikë e rëndësishme e politikave kulturore, etj.<sup>6</sup>

Ky raport ndalet në Qendrën Historike të Prishtinës, në shqetësimin për të dhe për të ardhmen e saj. Duke analizuar zhvillimet e fundit në këtë zonë, rëndësinë historike, vlerat e trashëgimisë arkitekture që ndërthuren brenda kufijve joekzistues të saj, të pathënat lidhur me trajtimin e gabuar të qendrës historike në dy dekadat e fundit; raporti tenton të pasqyrojë gjendjen e rëndë dhe të artikulojë urgjencën për intervenim të menjëhershëm për të shpëtuar pjesën e mbetur nga kjo zonë.

Raporti është bazuar mbi shqyrtimin e publikimeve të deritanishme mbi Qendrën Historike të Prishtinës, observimin e gjendjes në terren, intervistat me zyrtarët institucional, marrjen e opinionëve nga profesionistë të fushës si dhe analizat krahasuese nga rajoni. Raporti ndalet në identifikimin e problematikave kryesore dhe përfundon me konstatimet dhe rekomandimet.<sup>7</sup>

Nga elaborimi i hollësishëm i gjendjes së tanishme të kësaj zone, analizat në terren dhe intervistat me profesionistët, raporti përfundon me një sërë rekomandimesh drejtuar insitucioneve

5."GABIM PAS GABIMI, Analizë mbi gabimet e panumërta dhe të vazhdueshme në trashëgiminë kulturore", EC Ma Ndryshe për Forumin 2015, fq.12

6. "Konventa për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkitekture të Evropës", miratuar më 3 tetor 1985 në Granadë, Spanjë dhe hyrë në fuqi më 1 dhjetor 1987; dokument ligjor në nivel ndërkombëtar për harmonizim të rregulloreve mbi konservimin, zhvillimin dhe integrimin e trashëgimisë arkitekture në vendet evropiane.

7. "Qendra Historike" e Prishtinës numëron ditët e fundit, Raport Preliminar, Mars 2014, [http://www.onlinetransparency.org/repository/docs/Qendra\\_Historike\\_e\\_Prishtines\\_-\\_raport\\_preliminar.pdf](http://www.onlinetransparency.org/repository/docs/Qendra_Historike_e_Prishtines_-_raport_preliminar.pdf)

përgjegjëse, organizatave të shoqërisë civile dhe qytetarëve. Rekomandimet kryesore të raportit janë: ndërprerja e përkohshme e të gjitha aktiviteteve ndërtimore në zonë; rishqyrtimi i përgjegjësive institucionale; angazhimi i eksperëve për valorizimin e gjendjes aktuale në terren; definimi i kufijve; definimi i statusit ligjor të zonës në përgjithësi dhe objekteve në veçanti; hartimi i planit të Konservimit; aplikimi i qasjes së integruar dhe në fund, por jo më pak e rëndësishme, promovimi i rëndësisë së trashëgimisë kulturore për komunitetin.

## II. Historiku i bërthamës së qytetit

Veniçja e Prishtinës së dikurshme

Rrëfimi për Prishtinën fillon me Qendrën Historike të saj. Të dhënat tregojnë se kjo zonë është ndër të vetmet pjesë të strukturës urbane që ka vlera autoktone dhe mjedisore të trashëgimisë kulturore. Nga koha kur përmendej si "fshat", e deri në kohën e formësimit të kryeqendrës së ditëve të sotme, Prishtinës i parapriu zhvillimi i përqendruar i bërthamës së qytetit. I shtrirë në mes të dy lumenjve, qyteti u zhvillua ndër shekuj duke u dalluar për indin e rrugëve, objektet publike, ato fetare, çarshinë, kullën, hamamet, shtëpitë individuale e padyshim edhe për lëkurëpunuesit, qeleshepunuesit, kazanxhinjtë, vorbëtarët, cergaxhinjtë e të gjithë zejtarët e saj.

Ekzistojnë të dhëna të ndryshme mbi historikun e Prishtinës, varësisht nga burimet. "E tërë periudha e ekzistencës së saj është e shënuar përmes disa udhëpërshkrimeve që prej shekullit të XIII-të, kur për herë të parë përmendet si vendbanim i rëndësishëm, dhe tutje, si qytet i panairëve tregtare me shumë hane, çarshi të mbuluara me shumë dyqane, si pikë tregtare e rëndësishme midis Selanikut e Sarajevës, e deri në përfundimin e Luftës së Dytë Botërore kur ajo shpallet zyrtarisht kryeqendër e Kosovës dhe merr primatin e një pike të rëndësishme ekonomike kulturore të legjitimuar".<sup>8</sup> Mirëpo, sipas ark. Gjejlane Hoxhës, Prishtina (dhe me këtë i referohemi bërthamës së saj), është më e vjetër se kaq.<sup>9</sup>

Rëndësia e Prishtinës, sipas saj, ndërlidhet pikërisht me Qendrën Historike si qendër e zhvilluar urbane shumëfunktionale, metribute të jetës shoqërore, ekonomike, edukative, politike dhe kulturore.<sup>10</sup> Kjo Prishtinë idilike sot përjetohet vetëm në fotografitë e mbetura, si pjesë e një kujtese të patjetërsueshme. Struktura e dikurshme

8. "Trashëgimia e Prishtinës", CHwB, Trashëgimia kulturore pa kufij, Kosovë, 2008, fq.6

9. Bazuar në rezultatet e dalura (në shtresimet arkeologjike) nga projekti i MKRS lidhur me hulumtimin e datimit të Prishtinës, arsyeja e mospublikimit të të cilit dokument mbetet të shqyrtohet në të ardhmen

10. Qendra Historike e Prishtinës, Thirrje për konservim, Gjejlane Hoxha, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, Shtator 2011

e qytetit ishte e koncentruar në bërthamën me përmbajtje publike, prej së cilës shtriheshin rrugët e ngushta, të cilat gruponin shtëpitë individuale, duke formuar kompozicione 'mëhallash'.<sup>11</sup>

Rëndësia e Qendrës Historike qëndronte në çarshinë e qytetit që shtrihej mu në pjesën qëndrore të saj, si dhe dy indet urbane që kalonin mes përmes kësaj zone, 'divanjollit' dhe indi lindje-perëndim. "Më 1662 Prishtina veç posedonte zonë tregtare të mbuluar, kishte çarshinë dhe hamamin si dhe 11 hane dhe rreth 300 dyqane".<sup>12</sup> Zhvillimi i hovshëm i Prishtinës vazhdoi edhe më tej, duke e marrë primatin e kryeqendrës si dhe atë të qytetit më të madh prej Selanikut e gjer në Sarajevë.

Mirëpo, ajo që e bën të njihet jo për të mirë është trajtimi i saj politik dhe kulturor ndër dekada. Në Prishtinë u aplikuan metodologji shkatërruese dhe degraduese, duke filluar nga misioni për të sjellë modernen nën moton "Ta rrënojmë të vjetrën, ta ndërtojmë të renë", e duke vazhduar me shkatërrimet e vazhdueshme të cilat vazhdojnë të ndodhin edhe sot. Me Prishtinën u eksperimentua shumë herë, duke tjetërsuar identitetin karakterizues të saj dhe duke dërguar deri në devastimin e vlerve ekzistuese.

Çarshia si qendër kulturore, shoqërore, zejtare, tregtare dhe administrative e qytetit u shkatërrua me qëllimin e ndërtimit të zonës së re administrative, duke humbur në këtë mënyrë karakteristikat historike dhe mjedisore të pjesës qëndrore të qytetit.<sup>13</sup> Mbetjet nga kjo valë shkatërrimesh konsistojnë në tri xhamitë brenda kufijve të dikurshëm të zonës historike, hamamet, sahat kullën, shtëpitë individuale dhe objekte të tjera të karakterit publik.

## III. Rëndësia e Qendrës Historike

Aty ku zë fill një qytet

Që hapësira është protagoniste e arkitekturës është gjykim i paluhatsëm. Është relativ vlerësimi i një tërësie arkitekturale që sot shohim në qytetet tona, varësisht nga perceptimet tona individuale! Por është e pakontestueshme rëndësia që qendrat historike kanë për vetë kompozicionin e qyteteve. Ato u krijuan pa përkushtim ndaj të rregulltës, parimeve arkitekturale apo gjykimit për vetë hapësirën. U strukturuan pothuajse spontanisht dhe çdo interpretim i sotëm mbi këto tërësi

11. Termi 'Mahalla' nënkupton grupe shtëpish të orientuara rëndom me vizura nga rrugët e ngushta, me oborre të rrethuara me mure të larta; secila mahallë posedonte objektet me karakter publik. Referuar në 'Arhitektura Bosne i put u suvremeno', D.Grabrijan, J. Neidhardt, Ljubljana, 1957

12. "Trashëgimia e Prishtinës", CHwB, Trashëgimia kulturore pa kufij, Kosovë, 2008, fq.21

13. Plani Urbanistik Detal i Zonës Historike të qytetit me qendër tregtare", Pjesa Tekstuale, Enti Urbanistik i Komunës së Prishtinës, 1978



Ilustrim 1. Paraqitja skematike e çarshisë së Prishtinës  
"Arkitektura tradicionale-popullore e Kosovës", Dr.Sc. Flamur Doli



**Rëndësia e Qendrës Historike qëndronte në çarshinë e qytetit që shtrihej mu në pjesën qendrore të saj.**



**Berthama e Prishtinës ishte e veshur me petkun e mahallave, objekteve të kultit, krojeve, kullave, shtëpive me doksate e të gjitha elementeve të tjera të arkitekturës orientale.**

kompozicionale mund të luhasë ndjeshmërinë që banorët e dikurshëm e kishin ndaj hapësirës. "Përvoja hapësinore e mirëfilltë e arkitekturës zgjatet në qytet, në rrugë dhe në sheshe, në rrugica dhe në parqe, në stadione dhe në kopshte, kudo ku vepra e njeriut ka kufizuar disa 'boshllëqe' pra ku ka krijuar hapësira të mbyllura".<sup>14</sup>

Qytetet tona nuk do të krijonin vizionin që sot e kanë pa qendrat e tyre historike, të cilat pikërisht në shekujt e pushtimit osman u mveshën me petkun e çarshive, mëhallave, objekteve të kultit, krojeve, kullave, shtëpive me doksate e të gjitha elementeve të tjera të arkitekturës orientale. Ky ndikim u mishërua me autoktonen, duke prodhuar vlerat më të larta të trashëgimisë kulturore që sot i kemi. Këtu bëhet fjalë edhe për vetë mënyrën e jetesës.

Shkathësitë të cilët i kishin banorët e qyteteve tona për ushtrimin e zejeve, krijuan nevojën për përvetësimin e konceptit të pazareve, çarshive të mbuluara dhe të hapura, të cilat rëndom u krijuan përreth rrjedhës së lumenjve. "Pazari ishte tregues i vërtetë karakterizues për cilësimin qytet të një qendre të banuar, ku zhvillohej mbarë veprimtaria zejtare dhe njëkohësisht kryhej shitja e prodhimit artizanal".<sup>15</sup>

Gjakova, Prizreni, Peja, Mitrovica dhe Prishtina cilësoheshin si qendra banimi me theks të veçantë në zhvillimet administrative të cilat zinin vend rreth çarshive të tipologjive të ndryshe, në dyqanet e të cilave ushtroheshin zejet që tërhiqnin vizitorët dhe kalimtarët. Ndërsa rreth e rreth tyre zhvillohej jetesa me të gjitha atributet e një qytetetërimi të zhvilluar, nga shtëpitë individuale e deri te medresetë e bibliotekat.<sup>16</sup>

Rëndësia që qendrat historike kanë në kontekstin historik dhe përmbajtësor arkitektural bëri që ato të shndërrohen në pikat më të dëshirueshme për investime dhe përfitime të anshme në aspektin ekonomik në dy dekadat e fundit. Si rezultat i kësaj, duke mos qenë të mbrojtura juridikisht, në to u intervenua nga investitorë të ndryshëm, të cilët joshën banorët e shtëpive individuale që dhanë në këmbim pronat e tyre, duke flijuar kështu edhe pjesë të trashëgimisë kulturore. Intimiteti që rrugët e dikurshme në këto qendra të siguronin, sot janë zëvendësuar me ndërtime të reja që kanë humbur sensin e masës në arkitekturë. "Qendrat historike të Prishtinës, Prizrenit e Gjakovës sot pothuaj nuk ekzistojnë, pasi janë përfshirë nga ndërtimet e reja dhe të pakontrolluara pas lufte, krahas dëmeve shkatërruese të shkaktuara gjatë luftës".<sup>17</sup> Në këtë kontekst, padyshim theksi bie edhe mbi Prishtinën.

# KRAHASUESHMERIA E NDRYSHIMEVE NË QENDRËN HISTORIKE TË PRISHTINËS NË ASPEKTIN VIZUEL- DIKUR DHE SOT

*Prishtinasit e vjetër, dhe jo vetëm, kanë shumë pak të kujtojnë nga Prishtina e dikurshme. Krahasimet vizuele na bëjnë lehtë të identifikushme realitetin e asaj që është duke ndodhur në "Qendrën Historike" të Prishtinës.*



1



2



3



4



5



6



#### IV. Gjendja aktuale

Qendra e 'pa dukshme'

Që nga shkatërrimi misionar i pas Luftës së Dytë Botërore, Qendra Historike e Prishtinës kaloi në 'procese' të shumta të ndryshimeve. Fillimisht për hir të revolucionarizmit dhe sjelljes së 'modernes së kushtëzuar'. Masa intime u zëvendësua me bulevarde, e çarshia e dikurshme u propozua që të zëvendësohej me Planin Urbanistik Detal të vitit 1978. Periudha e para luftës së vitit 1999 dhe situata e lirisë së posa arritur pas këtij viti kanë dhanë kontributin e vet në zhvillimet në këtë qendër. Qeverisja lokale e Prishtinës nuk kishte strategji të qartë veprimi, duke krijuar hapësirë që shumë faktorë të ndikojnë gradualisht në zbehjen e Zonës Historike së dikurshme.

**Degradimi i vazhdueshëm i Qendrës Historike të Prishtinës** - Grupmoshat më të vjetra të Prishtinës, kanë shumë pak të kujtojnë nga Prishtina e dikurshme. Ajo që është duke ndodhur në Qendrën Historike të Prishtinës është shumë lehtë e identifikueshme nga komuniteti i gjerë. Disa shtëpi janë në rrënim e sipër, të tjerat janë djegur me apo pa qëllim, ndërsa dita ditës strukturat e vjetra po zëvendësohen me ato të reja. Restaurimet në disa objekte publike dhe fetare po vazhdojnë duke nxitur kritika për korrektësinë profesionale dhe juridike të intervenimeve në to. Gjendja e objekteve brenda kufijve të Zonës Historike të dikurshme është shqetësuese. Gjendja e objekteve dikur në mbrojtje shtetërore po përkeqësohet dita-ditës. Trajtimi i ndryshëm i fasadave ballore, aplikimi i materialeve jo-adekuate, trajtimi jo-adekuat i përmbajtjeve afariste në përdhësë janë duke e degraduar vazhdimisht këtë zonë. Por këto përcillen edhe me intervenime të tjera madhore, siç janë ndërtimet e objekteve të reja që tentojnë t'i korrespondojnë arkitekturës bashkëkohore, e që në fakt, i tjetërsojnë vlerat ekzistuese të trashëgimisë kulturore.

**Heshtja e insitucioneve dhe profesionistëve** - Përderisa Qendra Historike e Prishtinës po shkatërrohet, institucionet dhe profesionistët, pothuajse janë në heshtje të plotë. Për Qendrën Historike është duke u shkruar shumë pak dhe qytetarët, përveç asaj që mund ta shohin dhe përjetojë vetë, nuk provokohen aq shumë as nga

mediet. Për më tepër, mungon edhe promovimi i vlerave ekzistuese të trashëgimisë kulturore brenda "Zonës Historike" të dikurshme. Heshtja e përgjegjësve ka ndikuar edhe në mungesën e interesimit dhe vetëdijes së duhur të qytetarëve për vlerat e trashëgimisë kulturore. Nuk janë të rralla rastet kur vet banorët e pronave të mbrojtura kanë ndikuar në degradimin e vlerave ekzistuese të ndërtesave.

**Venitja e kujtesës kolektive** - Koha ka bërë që gjeneratat e reja, por edhe te vjetrat të kenë pak çka të kujtojnë nga trashëgimia kulturore dhe urb-arkitekturale e kësaj zone. Mungojnë publikimet, aktivitetet kulturore dhe përgjithësisht njoohuria për ekzistimin e vlerave në këtë zonë. Mungon interpretimi i këtyre vlerave edhe nga insitucionet shkollore. Shkatërrimi i kësaj zone ka dërguar më së shumti në shkatërrimin e kujteses kolektive. Vlerat ekzistuese dhe ndjenja e përgjegjësisë për ruajtjen e tyre është luhatur. Kujtimi për Prishtinën e dikurshme tashmë është venitur.

14. "Si ta kuptosh arkitekturën", Bruno Zevi, DITURIA 2013, fq.35

15. "Banesa qytetare kosovare e shek. XVIII-XIX, Prishtinë, 2006

16. "Çarshitë në qytetet e Kosovës, koncepti urbanistik dhe arkitekturor", E. Mulojli, P. Diplome, 2013

17. "GABIM PAS GABIMI, Analizë mbi gabimet e panumërta dhe të vazhdueshme në trashëgiminë kulturore", EC Ma Ndryshe për Forumin 2015, fq.11



# GJENDJA AKTUALE NË "QENDRËN HISTORIKE" TË PRISHTINËS-AKTIVITETI NDËRTIMOR NË TË DHE RRETH SAJ

1:20 000

## DEGRADIMI FIZIK

ndërtimet e objekteve të reja dhe anekseve pa e respektuar praninë e objekteve nën mbrojtje, distancën (perimetrit) e përcaktuar për ndërtim, etazhitetin dhe relacionin me vijën ndërtimore; shkatërrimet dhe jo mirëmbajtja e objekteve ekzistuese



# GJENDJA AKTUALE NË "QENDRËN HISTORIKE" TË PRISHTINËS-AKTIVITETI NDËRTIMOR NË TË DHE RRETH SAJ

1:20 000



## V.Zhvillimet nga viti 1978

### Kufijtë e lëvizshëm

Gjendja aktuale e Qendrës Historike të Prishtinës nuk mund të shpjegohet pa analizën e zhvillimeve nëpër të cilat kaloi që nga viti 1947, kur për hir të marrjes së primatit si kryeqendër politike e administrative e Kosovës, Prishtina u desh të sakrifikonte thelbin e traditës së dikurshme. Mirëpo, edhe pse pjesa më e madhe e asaj që e përbente bërthamën e qytetit u shkatërrua (ironikisht, duke u demoluara nga vetë qytetarët), meqenëse munguan fondet për realizimin e të gjithë fushatës prishës-ndërtuese, një numër i veprave të arkitekturës tradicionale arriti të mbijetonte. Ato u cilësuan dhe u shpallën si monumente kulturore. Për këtë arsye, Plani Gjeneral i vitit 1951 e shpalli këtë zonë në mbrojtje, si zonë historike. Me të njëjtën rëndësi, kjo zonë u trajtua edhe me Planin Gjeneral të vitit 1964. Kthesë në planifikimin urb-arkitekturual të kësaj zone bën Plani Urbanistik Detal i vitit 1978, si vit për t'u shënuar në aspektin e zhvillimit të bërthamës së Prishtinës.<sup>18</sup>

**Planifikimi urban në zonë** - Plani detal urbanistik i vitit 1978, hartuar nga Enti për Urbanizëm i Prishtinës, duke vlerësuar strukturën ekzistuese urbane dhe në bazë të koncentrimin të objekteve të vlerësuar në mbrojtje, ka vërtetuar kufijtë e Zonës Historike. Kjo zonë ishte ndër më delikatet krahasuar me të gjitha projektet, planifikimin e të planifikimin e të cilave po e bënte në atë kohë Enti për Urbanizëm i Prishtinës. Ark.Shqipe Nixha, ligjëruese në Departamentin e Arkitektues në Universitetin e Prishtinës, e cila e ushtronte profesionin e arkitektes në atë kohë në këtë institucion, tregon se kjo zonë për një kohë të gjatë u la si 'zonë e bardhë', në të cilën nuk planifikohej asgjë, krahasuar me zonat e tjera përreth, të cilave u ishin punuar Planet Urbanistike Detale. Kjo për shkak të kompleksitetit të trajtimit të saj.

Sipas përshkrimit në "Planin Urbanistik Detal të Zonës Historike të Qytetit me Qendër Zejtare", vendimi për të punuar Planin Urbanistik Detal të kësaj zone erdhi pasi që nga Plani Gjeneral i vitit 1951, kur edhe ishte përcaktuar bërthama historike, nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim përpos adaptimeve dhe intervenimeve sporadike në infrastrukturën themelore.

Në këtë mënyrë ishte bërë mbledhja dhe analiza e shënimeve të nevojshme, analiza e zonës së përfshirë, përcaktimi i karakteristikave të tërësive të veçanta, valorizimi i fondit ndërtimor si dhe ishte

18. Bazat e Konzervimit për "Qendrën Historike" të Prishtinës, BE/KE-Përkrahja për Promovimin e Diversitetit Kulturor në Kosovë, Prishtinë, Dhjetor 2012

dhënë zgjidhja e variantës më të përshtatshme për zhvillim të mëtutjeshëm hapësinor. Ndër caqet kryesore ceket te jenë: ruajtja e trashëgimisë historike dhe vlerave ambientale të kompleksit; rekonstruimi, restaurimi dhe revitalizimi i pjesës qëndrore të Zonës Historike; revitalizimi i objekteve ekzistuese dhe tërësive të cilat posedojnë vlera arkitekturale si dhe rikthimi i kujtesës së çarshisë përmes qendrës së re zejtare ku do të koncentroheshin të gjitha veprimtaritë zejtare, të ri-aktivizoheshin veprimtaritë tregtare dhe të stimulohej ekonomia e vogël.

"Inventarizimi ka treguar që kjo hapësirë, pas rrënimin të çarshisë së vjetër, është e vetmja tërësi e qytetit, e cila përmban në vete vlerat autoktone dhe ambientale të trashëgimisë ndërtimore".<sup>19</sup> Në bazë të kriterëve të parashtruara të vlerësimit gjatë inventarizimit në këtë kompleks janë dalluar objekte me vlerë monumentale të kategorizuara në: objektet e pavarura me vlerë monumentale, tërësitë e objekteve të pavarura me vlerë ambientale si dhe objektet në kundërshtim me ambientin. Për këto të fundit grupi punues kishte konstatuar se janë objekte të cilat nuk kanë ndonjë vlerë të caktuar të trashëgimisë arkitekturale për shkak se përfaqësonin rëndom anekse të objekteve ekzistuese, ndërtime mbi themelet e vjetra apo objekte të ndërtuara pa leje ndërtimi.

Plani Urbanistik Detal i vitit 1978 i jepte rëndësi të veçantë ndërtimit të qendrës zejtare, e cila do të kufizohej me tregun e qytetit. "Me tretman të tillë do të sigurohet në këtë hapësirë përjetimi i përbashkët, formimi i mesit atraktiv për vizitorët, zhvillimi i aktiviteteve zejtare, prezentimi folklorik dhe vlerat tjera ndërtimore të kësaj hapësire, të sigurohet tregëtia, hotelieria... gjegjësisht në kuptim të plotë të zhvillohen elementet turistike dhe të ekonomisë së vogël në pjesën qëndrore të qytetit".<sup>20</sup>

Plani i pa realizuar i vitit 1978 solli tentativa të tjera për të ristrukturuar këtë zonë. "Plani i ri gjeneral, i miratuar në vitin 1987, githashtu i konfirmoi parimet themelore lidhur me mbrojtjen e trashëgimisë ndërtimore në Zonën Historike të promovuara në aktet e mëparshme. Kufijtë e përkufizuar të zonës ishin vizatuar me saktësi në pasqyrën grafike të saj".<sup>21</sup>

Në ndërprerjen e procesit të planifikimit urban dhe jetësimit të atyre që ishin në fuqi, ndikuan vitet e pas luftës së fundit në Kosovë, pa lënë anash

19. Plani Urbanistik Detal i Zonës Zejtare miratuar në vitin 1978, Pjesa tekstuale, Ref.:05-024-45294, Komuna e Prishtinës, Mars 2014, fq. 4

20. Plani Urbanistik Detal i Zonës Zejtare miratuar në vitin 1978, Pjesa tekstuale, Ref.:05-024-45294, Komuna e Prishtinës, Mars 2014, fq. 3

21. Bazat e Konzervimit për "Qendrën Historike" të Prishtinës, BE/KE-Përkrahja për Promovimin e Diversitetit Kulturor në Kosovë, Prishtinë, Dhjetor 2012, fq.13

edhe ndikimet e regjimit të dhunshëm të viteve të '90-ta. Mirëpo, në vitin 2001 zona u përfshi në Planin Strategjik të Zhvillimit Urban të Prishtinës. "Mjedisi tradicional historik - Prishtina e Vjetër, me përbërje monumentesh dhe ansamblesh të shumënumërta, e pozicionuar përgjatë arteries rrugore të qendrës së qytetit, është pjesë integrale e qytetit modern të Prishtinës".<sup>21</sup>

Përpjekjet për të ndërmarrë masa parandaluese ndaj kanosjeve enorme në këtë zonë vazhduan. Vetëm në vitin 2006 u iniciua procesi i hartimit të një plani rregullativ për të ashtuquajturin "Qyteti i vjetër" i Prishtinës, kufijtë e të cilit korrespondonin me kufijtë e Zonës Historike nga Plani Urbanistik Detal i vitit 1978, me sipërfaqe afërsisht 26 hektarësh. Mirëpo, ndryshimet pasuan me planin e ri rregullativ të vitit 2009, me zgjerimin e kufijve të dikurshëm të zonës në 42 hektarë (prej 26 hektarë sa ishin).<sup>22</sup>

Ekspertët e vënë në diskutim arsyen e shtimit të kësaj sipërfaqeje. Sipas Gani Gashit, nga Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës, ky zgjerim është i paarsyeshëm për faktin se disa pjesë nuk e meritojnë të jenë në kufijtë e sotëm të Qendrës Historike. Gashi i referohet në veçanti pjesës veriore të kësaj zone. Të njëjtin mendim e ndan edhe ligjëruesja Shqipe Nixha, e cila thotë se ky vendim është i ngutshëm. "Vlerësimet në trashëgiminë kulturore janë procese që zgjasin shumë dhe ku duhet vepruar me shumë kujdes. Në këtë rast është dashur që së pari të identifikohen objektet të cilat meritojnë të jenë në mbrojtje dhe në bazë të përqëndrimit të vlerave të evidentuara, të përcaktohen kufijtë".<sup>23</sup>

Por Burbuqe Hydaverdi, nga Komuna e Prishtinës, shtimin e kësaj sipërfaqeje e arsyeton si preventivë për mos lejimin e ndërtimeve të larta rreth kufijve 20 hektarësh të Qendrës Historike të Prishtinës. "Sipërfaqja e shtuar në veri të kufijve ekzistues është shtuar në cilësinë e një 'tampon zone' në të cilën do të lejohet ndërtim jo më i lartë se përdhësë dhe katër kate (P+4)".<sup>24</sup> Sido që të jetë aktiviteti ndërtimor në zonë është duke vazhduar duke qenë i pa planifikuar dhe i pa monituoruar.

**Statusi ligjor i zonës dhe i objekteve në veçanti**  
- Territori në fjalë, e konceptuar si Qendra Historike e Prishtinës, konsiderohet të mos ketë

22. Qendra Historike e Prishtinës, Thirrje për konservim, Gjejlane Hoxha, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor, Shtator 2011

23. Bazat e Konzervimit për "Qendrën Historike" të Prishtinës, BE/KE-Përkrahja për Promovimin e Diversitetit Kulturor në Kosovë, Prishtinë, Dhjetor 2012

24. Shqipe Nixha, Profesoreshë pranë Universitetit të Prishtinës, Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës; shkëputje nga intervista e realizuar për qëllime të raportit

25. Burbuqe Hydaverdi, Komuna e Prishtinës, Drejtorja për Urbanizëm; shkëputje nga intervista e realizuar për qëllime të raportit

kufij të definuar, përderisa i mungon statusi ligjor dhe nuk është e mbrojtur si zonë. Ndër të gjitha zhvillimet, ky rezultat të jetë problemi kryesor i cili ka lënë më së shumti hapësirë për degradimin e skajshëm dhe sjelljen në gjendjen në të cilën është sot. Përgjegjësia për definimin e kufijve ligjorë bie mbi Ministrinë e Kulturës, por një gjë e tillë nuk është bërë deri më sot, edhe pse sipas ark. Vjollca Aliut, Drejtore e Departamentit për Trashëgimi Kulturor, vullneti ka ekzistuar. "Inicimi i definimit të kufijve të zonës historike, është çështje që është diskutuar me institucionet relevante por nuk është finalizuar; në këtë relacion ne kemi kërkuar mbështetjen e Këshillit të Evropes-Zyra në Prishtinë për ndërmarrjen e aktiviteteve të përbashkëta që do të lehtësojnë procesin, siç është publikimi mbi Bazat e Konzervimit për 'Qendrën Historike' të Prishtinës".<sup>26</sup>

Kërkesa për definimin e kufijve ka ardhur edhe nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Luan Nushi nga Instituti për Planifikim Hapësinor është deklaruar se nga ana e tyre është shprehur interesimi për të kontribuar në definimin e kufijve ligjorë të kësaj zone, si hap fillestar për normalizimin e gjendjes në të.

Objektet e kësaj zonë dikur në mbrojtje shtetërore, nga ligjet e ish-jugosllavisë, sipas Ligjit të Kosovës për trashëgimi kulturore nga viti 2006 gëzojnë një status tjetër, atë të mbrojtjes së përkohshme. Ky status duhet të ri-shqyrtohet çdo vit. Statusi mbrojtje e përkohshme vazhdohet sipas procedurës së rishikimit dhe rivlerësimit çdo vit, dhe si produkt final ka Listën e Trashëgimisë Kulturore në Mbrojtje të Përkohshme.


Valbona Sallauka, nga Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore e Prishtinës, thekson se kalimi nga mbrojtja e përhershme në atë të përkohshme vetëm sa e ka dëmtuar procesin në tërësi dhe ka rrezikuar gjendjen e objekteve në veçanti.

"Mungesa e aktit të shpalljes së pronave të trashëgimisë kulturore në mbrojtje të shtetit rrjedh si pasojë e mungesës së paraqitjes së propozimeve (nominimeve) pranë Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor, të cilat sipas ligjit në fuqi duhet të bëhen nga ana e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit".<sup>27</sup>

**Bartja e ndërsjellë e përgjegjësi  
institucionale - Ruajtja, mbrojtja dhe zhvillimi  
aktiv dhe i mirëfilltë i trashëgimisë kulturore është**

26. Vjollca Aliu, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, Drejtorja për Trashëgimi Kulturor, shkëputje nga intervista e realizuar për qëllime të raportit

27. Veprimtaria e KTK 2013 dhe Plani 2014, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor, Raport periodik, Prishtinë, Janar 2013, fq.6



12.

*Kufijt e "Zonës Historike" nga Plani Urbanistik Detal i '78-tës, përfshinin sipërfaqen prej 26 ha. Ndryshimet pasuan me planin e ri rregullativ të vitit 2009, me zgjerimin e kufijëve të dikurshëm të zonës në 42 ha (prej 26 ha sa ishin).*

1:20 000



**ZONA HISTORIKE**

**SIPAS PLANIT DETAL URBAN TË VITIT 1978**



**QENDRA HISTORIKE**

**SIPAS VENDIMIT TË KOMUNËS SË PRISHTINËS SË VITIT 2009**

1:20 000



ZONA HISTORIKE,  
Plani i Përgjithshëm i Prishtinës; Aprovuar në vitin 1988 për periudhën deri në vitin 2000

QYTETI I VJETËR,  
Plani Strategjik i Prishtinës; Aprovuar në vitin 2004 për periudhën deri në vitin 2020

detyrim kushtetues. Ligji për Trashëgiminë Kulturore, i miratuar në vitin 2006, lidhur me plotësimin e këtyre detyrimeve, ka ngarkuar autoritet dhe institucionet siç janë: Kuvendi i Republikës së Kosovës, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore (KKTK), Qeveria qendrore (Kryeministria, MKRS, MMPH, institucionet e trashëgimisë kulturore, të planifikimit territorial dhe kadastrë) dhe komunitat.

Ndryshimet e shpeshta në legjislacion dhe mos definimi i qartë i përgjegjësive institucionale ka ndikuar edhe në zhvillimet e fundit në Qendrën Historike të Prishtinës. Ngecjet në përmbushjen e detyrimeve kanë pamundësuar ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore dhe kanë ndikuar në shkatërrimin e vazhdueshëm të kësaj zone. Haxhi Mehmetaj nga Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore e Prishtinës insiston që personat të cilët kanë qenë të implikuar në tërë këtë proces, duhet të përgjigjen para drejtësisë dhe të ndëshkohen.

**Demolimi, djegia dhe shkatërrimi** - Aktiviteti i shtuar shkatërrues brenda Qendrës Historike të Prishtinës lidhet ngusht me objektet të cilat shtrihen në këtë zonë. Ark. Sali Shoshi nga Trashëgimia Kulturore pa Kufij, zyra në Prishtinë, referohet në të dhëna të cilat tregojnë për një përqindje të lartë të shkatërrimit të objekteve dikur të mbrojtura me ligj në Prishtinë (rreth 44%). "Sot është e pa diskutueshme se duhet të dilet në terren dhe të vlerësohet saktësisht se çka ka mbetur nga objektet e dikurshme në mbrotje".<sup>28</sup>

Gjendja e shumë objekteve (sidomos të shtëpive individuale) është mjaft e rëndë. Vizuelisht mund të supozohet se shumë prej tyre janë në rrezik të rrënimin të pjesshëm. Gjatë dy dekadave të fundit, nuk mungojnë rastet e rrënimin të qëllimshëm të strukturës së vjetër, për ta bërë zëvendësimin e saj me të renë. Gjatë viteve të fundit nuk kanë munguar as rastet e djegieve të qëllimshme. Supozimet për zjarrvënien të qëllimshme në ndërtesën e Unionit u shfaqën edhe në rastin e shtëpisë ku ka qenë e vendosur dikur konsullata ruse.<sup>29</sup> Gjendja ekzistuese e monumenteve është rrezikuar edhe nga ndërtimet e reja të cilat nuk kanë respektuar rrezin e obliguar për distancim në rastin e objekteve në mbrotje.

**Publikimet në lidhje me zonën** - Përkundër faktit se institucionet përgjegjëse kanë patur për detyrë që në vazhdimësi të bëjnë inventarizimin apo edhe incizimin e aseteve të trashëgimisë kulturore, mungojnë materialet arkivore, bibliotekare si dhe ato audio-vizuale. Edhe nëse këto të fundit

28. Sali Shoshi, CHWB, zyra në Kosovë; shkëputje nga intervista e realizuar për qëllime të raportit  
29. Preportr, "Prishtina e vjetër po zhduket", Besa Kalaja, Prishtinw, Dhjetor 2013, <http://preportr.com/sq/Sociale-Kulture/Prishtina-e-vjetër-po-zhduket-357>

ekzistojnë, mungon një sistemim i tyre dhe analizë e vërtetësisë së të dhënave. Pozitive në këtë drejtim mund të konsiderohen prurjet nga dy publikimet e fundit, "Trashëgimia e Prishtinës",<sup>30</sup> CHWB Prishtinë dhe "Bazat e konzervimit për Qendrën Historike të Prishtinës",<sup>31</sup> BE/KiE. Përkundër mangësive eventuale, këto dy publikime përbëjnë të vetmet burime që i kushtohen bërthamës historike të Prishtinës në aspektin kulturor, urbanistik dhe arkitektural të saj.

**Restaurimet e objekteve brenda zonës** - Përderisa objektet brenda zonës së emëruar si Qendra Historike e Prishtinës vazhdojnë të gëzojnë mbrojtje të përkohshme, faktori kohë ka ndikuar edhe në gjendjen e tyre të përgjithshme. Autoritetet qeverisëse në mes të objekteve të banimit dhe atyre fetare, kanë zgjedhur këto të fundit si më parësore për intervenimet e procesit të restaurimit. Mirëpo intervenimet e tilla, edhe pse me investime të konsiderueshme, janë cilësuar negativisht nga shumë kritik. Projektet e restaurimit mendohet se më shumë kanë zbehur vlerat e gjendjes burimore të objekteve. Nga mediat e shkruara shumë herë është ngritur brenga se nuk janë konsideruar konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e trashëgimisë dhe nuk janë konsultuar profesionistë të lëmive relevante. Sipas Udhëzuesit për Trashëgiminë Kulturore për secilën ndërhyrje, varësisht nga nevoja e intervenimit në objekt, duhet të punohen projektet përkatëse. Këto mund të jenë projektet për: ndërmarrjen e masave/ndërhyrjeve parandaluese, kryerjen e punimeve konservuese, kryerjen e punimeve në strukturën e asetit, kryerjen e punimeve për adaptim, kryerjen e punimeve restauratore, kryerjen e punimeve rindërtuese, si dhe marrjen e masave mbrojtëse dhe ndërhyrjeve të tjera. Nga të gjitha këto kategori të intervenimeve, në rastin e objekteve në Qendrën Historike janë kryer vetëm disa punime konservuese dhe restauruese duke i dhënë përparësi atyre publike.<sup>32</sup> Udhëzuesi më tej specifikon edhe fazat e punimeve dhe dokumentacionin e nevojshëm për pregaditje para se të intervenohet në një strukturë të vjetër ekzistuese.

Por rastet e intervenimeve në Qendrën Historike dëshmojnë që edhe përkundër faktit që është tentuar të arrihet një përsosmëri profesionale në përpilimin e projektit zbatues (për shembull në rastin e Hamamit të Madh), ekzekutimi i punimeve

30. Raportin mund ta lexoni në: [http://chwb.org/kosovo/wp-content/uploads/sites/3/2014/07/Publication\\_2008\\_1.pdf](http://chwb.org/kosovo/wp-content/uploads/sites/3/2014/07/Publication_2008_1.pdf)

31. Raportin mund ta lexoni në: <http://www.coe.int/t/dg4/cultureheritage/cooperation/kosovo/publications/20130129-PrishtinaCS.pdf>

32. "Udhëzues për Trashëgiminë Kulturore", dokument i prodhuar brenda kornizës së projektit "BE/KE-Përkrahje për Promovimin e Diversitetit Kulturor në Kosovë", 2012, fq. 79



**Intervenimet në Hamamit të Madh kanë dërguar deri në shkatërrimin e vlerave të gjendjes burimore të tij.**



**Humbja e elementeve burimore, aplikimi i materialeve bashkëkohore e në masë të madhe betonimi i strukturave të këtij monumenti, ka dërguar deri në tjetërsimin enorm të asaj që dikur njihet si Hamami i Madh i Prishtinës**



**Në Xhaminë e "Jashar Pashës", për shkak të zhagjës së punëve restauruese, gjendja e enterierit përveq nostalgjisë për vlerat e dikurshme të saja, të sjell keqardhje.**

ka dërguar deri në shkatërrimin e vlerave të gjendjes burimore të tij. Humbja e elementeve burimore dhe aplikimi i materialeve bashkëkohore e në masë të madhe betonimi i strukturave të këtij monumenti kanë shkaktuar tjetërsimin enorm të asaj që dikur njihet për Hamamin e Madh të Prishtinës. E tërë kjo supozohet të ketë ardhur për shkak të mosrespektimit të projektit dhe diskutimeve të shumta nga ekspertë vendor lidhur me intervenimin restaurator në të. Sipas ark. Sali Shoshi, fati i këtij objekti është dëshmi se duhet shqyrtuar marrëdhënia e punëkryesve dhe autoriteteve mbikëqyrëse, për të cilët mendohet të ketë shkelje ligjore dhe shfrytëzim të postit për përfitime personale.<sup>33</sup>

"Një raport rreth punimeve që po bëheshin në Hamamin e Madh, e kishte bërë edhe autori i këtij projekti në vitin 2009. Në vizitën që i kishte bërë hamamit në maj të atij viti, eksperti turk, Mustafa Pehlivanogllu, kishte konstatuar se punët që po bëheshin në hamam nuk kishin zbatuar udhëzimet e projektit të monumentit".<sup>34</sup> Për mosrespektim të projektit ka patur edhe reagimet nga palët e tjera, por sot që intervenimet në këtë objekt janë para përfundimit, e tëra që diskutohet nga përfaqësuesit e institucioneve përgjegjëse është destinimi që ky objekt do të ketë në të ardhmen, duke ia lënë të kaluarës dëmet që kanë ndikuar në degradimin e këtij monumenti me rëndësi në rradhë të parë historike e arkitekturale.

Tjetër problem i trashëgimisë kulturore në zonë është edhe mënyra e realizimit të projekteve intervenuese në këto objekte. Një numër i konsiderueshëm i intervenimeve restauratore në Qendrën Historike janë realizuar përmes donacioneve të jashtme. Pothuaj në të gjitha rastet, institucionet shtetërore kanë treguar gatishmëri të shkajshme për t'i aprovuar këto projekte, duke iu përshtatur të gjitha kërkesave dhe metodave të intervenimit nga donatorët përkatës. "Si pasojë e kësaj 'pavarësie' të palës donatore (agjenci shtetërore, organizatë ndërkombëtare, filantropi private), janë përdorur metodologji të ndryshme të konservimit".<sup>35</sup>

Agjencia Turke e Koordinimit dhe Bashkëpunimit TIKA, përveç punëve restauratore të përcjella me kritika ka lënë peng zhvillimet në njërën ndër objektet më të rëndësishme të kësaj zone. TIKA, që ka kryer punimet në Xhaminë e Madhe, nuk po i realizon ato në Xhaminë e "Jashar Pashës". Një tabelë e vendosur si paralajmërim për fillimin e

33. Sali Shoshi, CHwB, zyra në Kosovë; referuar nga intervista e realizuar për qëllime të raportit

34. Preportr, "Prishtina e vjetër po zhduket", Besa Kalaja, Prishtinw, Dhjetor 2013, <http://preportr.com/sq/Sociale-Kulture/Prishtina-e-vjetër-po-zhduket-357>

35. "GABIM PAS GABIMI, Analizë mbi gabimet e panumërta dhe të vazhdueshme në trashëgiminë kulturore", EC Ma Ndryshe për Forumin 2015, fq.38

punimeve është vënë në harresë bashkë me objektin. Çarjet e mëdha që iu paraqitën ndërtesës si pasojë e jostabilitetit të konstruksionit dhe trafikut të dendur, shumë shpejtë mund të çenojnë qëndrueshmërinë e përgjithshme.

E fat më të mirë nuk gëzon as "Xhamia e Çarshisë". EC Ma Ndryshe ka hulumtuar të rejtat lidhur me punimet restauruese të nisura kaherë në këtë objekt. Projekti i konservimit dhe restaurimit të Xhamisë së Çarshisë i filluar në vitin 2011, ka ardhur si marrëveshje në mes të Komunës së Prishtinës si donatore e projektit dhe Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës (IMMK) si punëkryese. Për kryerjen e punimeve deri më tani nga Komuna e Prishtinës janë ndarë jo më pak se 562,000 euro. Por punimet e parapara të përfundojnë në vitin 2013 kanë ngecur, duke e lënë objektin të rrethuar me skele tash e një kohë. "Sipas IMMK-së, për përfundimin e tërësishëm të punimeve të projektit nevojiten edhe rreth 95,000 euro, meqë komuna nuk ka llogaritur koston e projektit, por vetëm atë të punimeve".<sup>36</sup>

Këto raste veç e veç vënë në pah se si monumentet e "Qendrës Historike" të Prishtinës i janë nënshtruar një procesi të vazhdueshëm të degradimit si rezultat i një moskoordinimi institucionesh.

## VI. Kaosi i ndërmjetëm

Duket qartë që është e vështirë të flitet sot për bërthamën e dikurshme të këtij qyteti. Së paku jo për vlerat karakteristike të dikurshme të saj. "Sot, Prishtina si qytet urban shqiptar i periudhës osmane pothuajse është zhdukur plotësisht, përpos ca lagjeve të cilat ende ruajnë disa nga rrugët e ngushta dhe disa ndërtesa të rralla të vlefshme, por pa karakterin e kohërave të vjetra".<sup>37</sup> Në bërthamën historike të Prishtinës aktiviteti ndërtimor nuk u ndal asnjëherë, me hov më të madh në periudhën e pasluftës, kur për nevoja të tyre, qytetarët u ndien të lirë të ndërtojnë çkado. "Sot problemi qëndron në faktin se të dy qytetet kanë shkuar: i vjetri për hir të së resë (modernes) dhe i riu përsëri për hir të së 'resë' (postmodernes)".<sup>38</sup>

Nëse ajo çka u ndërtua në dy dekadat e fundit në këtë zonë mund të quhet postmodernizëm, figurativisht ky kaos do të duhej ta kishte një shpjegim logjik. Si lëvizje në arkitekturë,

posmodernizmi duhet të sillte në këtë zonë një revoltë të zhvillimit urban ndaj formalizmit të dikurshëm uniform të modernes.<sup>39</sup> Një revolucion mbi 'monotoninë e hirtë' të objekteve të ndërtuara në periudhën e socializmit. Por fatkeqsisht, aktiviteti ndërtimor i dekadave të fundit në këtë zonë nuk gëzon epitetin e ndonjë lëvizjeje në arkitekturë, aq më pak të postmodernes. Aty u ndërtua pa konsiderata etike. Dhe njëkohësisht kjo vazhdoi edhe në të gjitha qendrat e tjera historike të qyteteve tona, duke sjellë rezultate fatale për vlerat e trashëgimisë kulturore.

Ironia më e madhe qëndron në politizimin e shpeshtë të kësaj problematike. Gjatë fushatave parazgjedhore kjo zonë u përfol shumë herë si potencial për investime dhe detyrim për sensibilizim të qytetarëve për vlerat e trashëgimisë kulturore.

"Për të përmirësuar shpërndarjen e aktivitetit njerëzor mbi territor, duhet përmirësuar raportet ekonomike e sociale nga të cilat varet ky aktivitet; nga ana tjetër, nuk mjafton të përmirësosh marrëdhëniet ekonomike dhe shoqërore, në mënyrë që ato hapësinore të jenë automatikisht të sakta, por modifikimi i raporteve hapësinore është një nga mënyrat, e pandarë nga të tjerat, për të zbatuar ekuilibrin e përgjithshëm, që është qëllimi i veprimit politik".<sup>40</sup> Qendra Historike ishte edhe pjesë e platformave zgjedhore të partive politike, ndërsa premtimet për zgjidhjen e problemeve në këtë zonë e mundën diskutimin mbi përgjegjësinë e institucioneve që kishin toleduar degradimin për 15 vite rresht. Qeveria e kaluar lokale propozoi revitalizimin e kësaj zone, me theks rimeralizimin e rrugëve dhe kthimin e motiveve të dikurshme. Mirëpo qeveria e re lokale filloi punën me kritikë ndaj qeverisë së kaluar, duke i publikuar faktet mbi planet urbanistike të pasistemuara.

Reagimi i EC Ma Ndryshe ishte publikimi i të gjeturave nga hulumtimi mbi planet rregullative dhe zhvillimore të Prishtinës si dhe si dhe shqyrtimi i gjendjes në Qendrën Historike.<sup>41</sup> Për të ngritur shqetësimin rreth trajtimit të trashëgimisë arkitekturale dhe zonave të mbrojtura, me theks në gjendjen kaotike të krijuar në bërthamën historike të Prishtinës, u reaguua lidhur me Ligjin e Trajtimit të Ndërtimit pa Leje. "Për të evidentuar këto zona të mbrojtura, bazuar në Ligjin për Trashëgiminë dhe listen e objekteve në mbrojtje të përkohëshme, OJQ EC Ma Ndryshe e punoi një hartë, në të cilën paraqiten të gjitha ndërtimet që

36. "As këtë vit nuk përfundon restaurimi i Xhamisë së Çarshisë në Prishtinë", Komunikatë për Media, EC Ma Ndryshe, Prishtinë, Korrik 2014

37. "Trashëgimia e Prishtinës", CHwB, Trashëgimia kulturore pa kufij, Kosovë, 2008, fq.21

38. "Trashëgimia e Prishtinës", CHwB, Trashëgimia kulturore pa kufij, Kosovë, 2008, fq.12

39. Postmodernizmi në arkitekturë, <http://www.saylor.org/site/wp-content/uploads/2011/05/Postmodern-architecture.pdf>

40. "Origjinat e urbanistikës moderne", Leonardo Benevolo, DITURIA 2011, fq.11

41. <http://online-transparency.org/?page=1,44>





*Planet urbanistike dhe dokumentacioni përcjellës i pasistemuar pasqyrojnë jo seriozitetin e trashëguar në Komunën e Prishtinës lidhur me trajtimin e problematikës së Qendrës Historike dhe më gjerë.*



*Për revitalizimin e Qendrës Historike të Prishtinës nga udhëheqja e kaluar u prezentua projekti mbi intervenimin në të, me theks në rimateriaizimin e rrugëve dhe kthimin e motiveve të dikurshme.*



*EC Ma Ndryshe punoi një hartë, në të cilën paraqiten të gjitha ndërtimet që janë në listën e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme si dhe perimetri prej 50 metrash që përbën zonat e mbrojtura rreth atyre ndërtimeve*

janë në listën e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme në qytetin e Prishtinës, si dhe perimetri prej 50 metrash që përbën zonat e mbrojtura rreth atyre ndërtimeve".<sup>42</sup>

## VII.Problematikat

*Aty ku fillon dhe s'perfundon përgjegjësia*

Gjendja ekzistuese në Qendrën Historike të Prishtinës rezultojnë të jetë alarmante. Aktivitetet brenda zonës dhe loja e bartjes së ndërsjelltë të përgjegjësive insitucionale sjellin në pah këto problematika kryesore:

**Mungesa e bashkëveprimit ndër-insitucional (MKRS-MMPH-Komunë)** - Bashkëveprimi në mes të këtyre tri institucioneve rezultojnë të jetë një qark që nuk mbyllet. MKRS ka barrën kryesore dhe si e tillë nga ekspertët kritikohet për ngecjen e procesit të bashkëveprimit me MMPH dhe Komunën e Prishtinës. Thirrjet nga këto të fundit për definimin e statusit të zonës dhe objekteve si dhe kufijve të zonës, rezultojnë të mos jenë pritur me entuziazmin e menduar. Nga të gjitha palët e intervistuar rezultojnë se që të gjitha autoritetet përgjegjëse janë të vetëdijshëm për ugjencen e shyrqimit të gjendjes së Qendrës Historike të Prishtinës, mirëpo iniciativa pritët pikërisht nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.<sup>43</sup>

**Mungesa e kufijve të definuar zonës** - Mungesa e statusit ligjor paraprihet nga mungesa e kufijve të definuar të zonës. Edhe pse Qendrës Historike të Prishtinës shpesh i referohemi si Zonë Historike e Prishtinës, në fakt ajo nuk është fare e definuar si e tillë. Fakti që momentalisht referohemi në kufij të ndryshëm të planeve urbanistike, tregon për një paqëndrueshmëri të qasjes së përgjithshme ndaj kësaj problematike. Kufijtë e zonës duhet të definohen në bazë të mbetjeve dhe potencialit të mundshëm të vlerave të trashëgimisë kulturore.

**Mungesa e statusit ligjor për zonën** - Pa definim të kufijve të asaj që do ta përcaktonin si zonë, sipërfaqja e trajtuar me përmbajtje të mundshme të vlerave të trashëgimisë kulturore nuk mund të definohet me status ligjor. Fakti që kjo zonë nuk është e mbrojtur, ka ndikuar drejtpërdrejt në degradimin e vazhdueshëm të saj. Në rast se kjo zonë do të gëzonte status të përcaktuar (në mbrojtje) atëherë kjo do të ndihmonte në parandalimin e aktiviteteve degraduese në të dhe në rrethinë. Vetëm statusi në mbrojtje (të përkohshme) i monumenteve të veçanta, nuk e ka

42."Trajtimi i ndërtimeve pa leje përbrenda zonave të mbrojtura", Komunikatë për Media, EC Ma Ndryshe, Prishtinë, Qershor 2014

43.Shënim: lista e të gjithë personave, përfaqësues të institucioneve, të intervistuar me qëllim të realizimit të këtij raporti është e bashkangjitur në fund.

ndihmuar mbrojtjen e zonës në përgjithësi.

**Mbrojtja e përkohshme** - Sipas profesionistëve, kalimi nga mbrojtja e përhershme në mbrojtje të përkohshme vetëm sa i ka dëmtuar monumentet dhe gjendjen burimore të tyre. Monumentet brenda kësaj zone kanë nevojë për re-inventarizim dhe definim të statusit të tyre në mënyrë që të parandalohet shkatërrimi i vazhdueshëm në emër të mbrojtjes së përkohshme që e gëzojnë. "Sipas ecures së proceseve të mbrojtjes, pronat e trashëgimisë kulturore identifikohen, regjistrohen, dokumentohen, vlerësohen, propozohen dhe përcaktohen për mbrojtje sipas Inventarit Shtetëror".<sup>44</sup> Përpilimi i listës së objekteve në mbrojtje të përhershme është një obligim i papërbushur ende.

**Aktiviteti ndërtimor brenda zonës** - Aktiviteti ndërtimor në këtë zonë nuk ka të ndalur. Edhe pse nga autoritetet komunale këto mohohen, objekte të reja, në disa raste edhe të një etazhiteti të mesëm dhe të lartë janë duke u ndërtuar në afërsi të objekteve në mbrojtje. Ekziston një paqartësi rreth rrugës që aplikuesit duhet të ndjekin për t'u pajisur me leje ndërtimore në këtë zonë. Përderisa Komuna e Prishtinës supozon se i procedon kërkesat në Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturore të Prishtinës, rekomandimet e këtyre të fundit rezultojnë se nuk merren parasysh. Struktura të reja janë duke u ndërtuar në afërsi të monumenteve nën mbrojtje duke mos respektuar etazhitetin, konceptin e arkitekturës tradicionale të zonës, materializimin, si dhe rrezën e distancimit.

Një nga sfidat që ka evidentuar ky hulumtim është mbarëvajtja e punimeve në komisionin e MKRS, i cili bën shqyrtimin e rasteve të ardhura nga Komuna e Prishtinës për ndërtime të reja në afërsi të objekteve në mbrojtje, apo intervenimet në ato ekzistuese. Haxhi Mehmetaj, si anëtar i këtij komisioni, ka shprehur shqetësimin e tij se puna e këtij komisioni mund të ketë dështuar pikërisht si rezultat i manipulimeve.

**Mospenalizimi i shkatërruesve** - Është bërë traditë që të digjet apo shkatërrohet e vjetra në mënyrë që lirshëm t'i lëshohet vend të resë. Janë vërejtur edhe rastet kur pronarët e objekteve me vlera të trashëgimisë kulturore, të pakënaqur me gjendjen e objekteve për të cilat duhet të kujdesen vetë dhe pa përkrahje dhe lehtësime nga institucionet, zgjedhin që të shkatërrojnë pronat e tyre, të joshur nga përfitimet që mund t'i kenë nga ndërtimet e reja si zëvendësim. Deri tani, këto krime ndaj vlerave kulturore kanë mbetur të

44."GABIM PAS GABIMI, Analizë mbi gabimet e panumërta dhe të vazhdueshme në trashëgiminë kulturore", EC Ma Ndryshe për Forumin 2015, fq.36

pasanksionuara. Ligji në fuqi ngarkon me vlera të caktuara materiale penalizimet për ata që janë akterë të dëmtimit të trashëgimisë kulturore. Por përvoja ka dëshmuar të kundërtën, duke i liruuar shkelësit nga aktakuzat e ngirtura, me pagesa simbolike.

Edhe pse mund të thuhet se përgjegjës për kufizimin e rrënimëve dhe dëmtimin fizik të trashëgimisë arkitekturnale janë të gjitha palët (institucionet përgjegjëse, profesionistët, shoqëria civile dhe vetë qytetarët), përgjegjësia kryesore sipas Konventës për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkitekturnale të Europës bie mbi vetë organet mbikëqyrëse. "Çdo pale merr përsipër të sigurojë që brenda mundësive të tyre që organet mbikëqyrëse të reagojnë në mënyrë të përgjegjshme dhe adekuate për shkelje të ligjit për mbrojtjen e trashëgimisë arkitekturnale".<sup>45</sup>

**Mungesa e inventarit shtetëror** - Është më se e dukshme se premtimi mbi mundësinë e një qasjeje sistematike ndaj trashëgimisë kulturore dhe realizimi jo i tërësishëm i tij ka sjellë probleme në ruajtjen e traditës dhe përpilimin e formave për promovimin e saj. Përcaktimi i listës së objekteve në mbrojtje të përhershme, valorizimi i gjendjes në terren si dhe definimi i kufijve ligjorë të kësaj zone është ngusht i lidhur me mungesën e të dhënave të regjistruara lidhur me secilin objekt në veçanti. Për më tepër mungesa e informatave lidhur me objektet në veçanti dhe zonës në përgjithësi vështirëson secilin studim të iniciuar mbi këtë zonë. Si rezultat i mungesës së dokumentacionit gjithëpërfshirës të trashëgimisë kulturore është e vështirë që të arrihet në vlerësimet adekuate dhe marrjen e masave mbi statusin e kësaj zone. "Të dhënat e mbledhura nga institucionet për mbrojtje janë të pamjaftueshme për një shqyrtim më të detajuar të arsyeve për vënien e objekteve të caktuara në mbrojtje, monitorimin e gjendjes së tyre, qoftë në kontekst të intervenimeve të ndërmarra apo të ndryshimeve të funksionit dhe ndryshimeve të tjera të mjedisit në afërsi".<sup>46</sup>

## VIII. Rekomandimet

Më keq se asnjeherë, më vonë se kurrë

Sado e pashpresë që duket gjendja aktuale në Qendrën Historike, EC Ma Ndryshe beson në një mundësi të fundit për reagim dhe i ofron këto rekomandime<sup>47</sup>:

45."GABIM PAS GABIMI, Analizë mbi gabimet e panumërta dhe të vazhdueshme në trashëgiminë kulturore", EC Ma Ndryshe për Forumin 2015, fq.36

46.Bazat e Konzervimit për "Qendrën Historike" të Prishtinës, BE/KE-Përkrahja për Promovimin e Diversitetit Kulturor në Kosovë, Prishtinë, Dhjetor 2012, fq.10

47.Në formulimin e rekomandimeve, kontribut të veçantë kanë dhënë edhe profesionistët e intervistuar gjatë këtij hulumtimi.

**Ndërprerja e përkohshme e të gjitha aktiviteteve ndërtimore në zonë** - Për të parandaluar shkatërrimin dhe degradimin e mëtutjeshëm në zonë, ne iu bëjmë thirrje institucioneve komunale që të ndërpriten në afat të pacaktuar çdo aktivitet ndërtimor. Konsiderojmë se valorizimi i vlerave të mbetura të trashëgimisë arkitekturale brenda zonës dhe përcaktimi i kufijve ligjorë të saj është një proces i ngadalshëm dhe shumë kompleks. Në mënyrë që të mos thellohen gabimet e deri tanishme, rekomandojmë që në këtë periudhë të mos vazhdohet me aktivitete ndërtimore, restauruese dhe intervenime të tjera të cilat vetëm se do ta rëndonin gjendjen në Qendrën Historike të Prishtinës.

**Rishqyrtimi i përgjegjësive institucionale** - Të tejkalohet mungesa e bashkëveprimit në mes të institucioneve përgjegjëse të përcaktuara me Ligjin për Trashëgiminë Kulturore. MKRS, MMPH dhe Komuna e Prishtinës duhet të nisin veprime të koordinuara për trajtimin e problematikave të kësaj zone. Në veçanti, funksionalizimi i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore (emërimi i anëtarëve) do të hapte rrugën për kompletimin e ciklit të mbrojtjes së përhershme.

**Angazhimi i ekspertëve** - Meqenëse trajtimi i Qendrës Historike të Prishtinës është çështje shumë komplekse dhe me përgjegjësi të lartë, është e nevojshme që të përfshihen profesionistë të lëmive përkatëse (trashëgimi, urbanizëm, arkitekturë, histori, art, jurisprudencë, përfshi edhe përfaqësuesit nga Universiteti i Prishtinës), pa anashkaluar edhe ekspertët ndërkombëtarë të dëshmuar në trajtimin e qendrave historike.

Meqenëse përcaktimi i kufijve ligjorë të një zone historike dhe revitalizimi i saj është një proces që ndodh pa përsëritje në periudha të gjata kohore, të inkurajohet përfshirja sa më e madhe e ekspertëve me përvojë në këtë lëmi, vendorë dhe të huaj. Veçanërisht të stimulohet pjesëmarrja e studiuesve të rinj si dhe studentëve nga Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës. Mobilizimi i të gjithë akterëve do të mund të rezultonte në zgjidhjet më të favorshme për këtë zonë.

**Të valorizohet çka ka mbetur nga kjo zonë** - Të merret një aksion incizimi dhe inventarizimi në terren për shqyrtimin e objekteve të mbetura dhe të bëhet evidentimi i vlerave të trashëgimisë dhe atyre urb-arkitekturale në zonë. Mobilizimi i grupeve të studentëve apo edhe vullnetarëve të përcjellë nga një staf profesionist për të bërë incizimin e gjendjes në terren do t'i paraprinte procesit të vlerësimit se çka ka mbetur si vlerë e ruajtur nga lista e dikurshme e objekteve me mbrojtje të përhershme dhe çka nga Zona

Historike e vitit 1978. Në të njëjtën kohë, të shqyrtohen edhe mundësitë e rikonstruimit të objekteve të rëndësishme të cilat janë zhdukur.

**Të bëhet definimi i kufijve** - Njohja e vlerave të mbijetuara të objekteve brenda zonës do t'i paraprinte procesit të përcaktimit të kufijve të saj. Objektet me vlera të trashëgimisë kulturore dhe potenciali i zhvillimit të aktiviteteve në afërsi të tyre do të shërbente si indikator për nevojën e zgjerimit (apo ngushtimit) të kufijve të Zonës Historike të dikurshme.

**Mbrojtja e përhershme ligjore** - Në afat sa më të shkurtër Ministria e Kulturës duhet të ofrojë status të definuar si mbrojtje e përhershme për objektet me vlera të trashëgimisë kulturore brenda zonës. Kjo do të pengonte dhe ndalonte përfundimisht degradimin e vazhdueshëm të tyre dhe do të hapte mundësinë për sanksionimin e veprave penale të shkatërrimit të trashëgimisë kulturore. Po ashtu, zona si sipërfaqe e definuar duhet të gëzojë status të mbrojtjes së përhershme ligjore, i cili do t'i mbronte kufijtë e saj dhe të gjithë aktivitetin ndërtimor brenda saj.

**Të procedohet me planin e Konservimit** - Rivlerësimi dhe ripërcaktimi i territorit të Zonës Historike të dikurshme të Prishtinës do të hapte mundësinë e hartimit të Planit të Konservimit. Me qëllim të ruajtjes së vlerave historike, arkeologjike, arkitekturale, atyre kulturore dhe të kujtesës kolektive, për këtë zonë është më se i domosdoshëm përpilimi i një plani multi-disiplinar i cili do të vinte në pah vlerat e këtij lokacioni dhe do të planifikonte aktivitete që do ta shtonin mirëqenien shoqërore dhe kulturore. Një Plan Konservimi, i përcjellë me Planin e Menaxhimit do të mundësonte përcjelljen e politikave lokale të qytetarët, investitorët e rinj si dhe do të vinte në pah potencialin për zhvillim ekonomik dhe turistik që kjo zonë ngërthen në vete.

**Qasje e integruar** - Të gjitha ndërhyrjet në Qendrën Historike duhet të realizohen në përmes kriterëve të konservimit të integruar.<sup>48</sup> Duke qenë se trashëgimia kulturore është përgjegjësi shumë më e gjerë se sa e një institucioni të vetëm, lidhur me trajtimin e Qendrës Historike të Prishtinës rekomandohet që MKRS-MMPH-KP të mos përjashtojnë njëra-tjetrën. Bashkëpunimi i ndërsjellë do të mund të sillte rezultate të frytshme të cilat jo vetëm do të arrinin të ndalonin vazhdimin e degradimit të kësaj zone, por edhe do të mund

48. Konservimi i integruar është pjesë e procesit të përgjithshëm të planifikimit dhe menaxhimit të qyteteve dhe territoreve në pajtim me perspektivën multireferuese (ekonomike, politike, sociale, kulturore, ambientale dhe hapësinore). Ai përqëndrohet tek (por nuk kufizohet vetëm në) aspektet fizike dhe hapësinore të zonave të konsoliduara që për nga aspekti social janë të njohura për vlerat kulturore për brezat aktualë dhe për brezat e ardhshëm.

të implikonin të gjitha aktivitet e ardhshme të planifikuara për këtë zonë, duke nisur nga planifikimi urbanistik, trajtimi i objekteve pa leje, dhënja e propozimeve për revitalizim si dhe zhvillimi i ardhshëm ekonomik i zonës në përgjithësi.

**Promovimi i rëndësisë së trashëgimisë kulturore për komunitetin** - Institucionet përgjegjëse, duhet të hartojnë programe të veçanta për promovimin e trashëgimisë kulturore për ngritjen e vetëdijes së përgjithshme mbi rëndësinë e saj për komunitetin. Lidhur me këtë, të ndërmerren masa për organizimin e punëtorive dhe formave të tjera edukative, të cilat do të mund të shpërndanin informatën lidhur me vlerën e trashëgimisë në përgjithësi, e të bërthamës historike të Prishtinës në veçanti. Peshë e përgjegjësisë bie edhe mbi shoqërinë civile e cila do të duhet të ishte më shumë aktive për rastin e Qendrës Historike të Prishtinës. Reagimi mbi degradimin e vazhdueshëm të saj duhet të pasohet me ndërmarrjen e projekteve të mobilizimit qytetar për mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore.

## Referencat

### Literatura

Trashëgimia e Prishtinës, CHwB Kosovo office, 2008

Bazat e Konzervimit për "Qendrën Historike" të Prishtinës, 2012

A history of Architectural Conservation, Jukka Jokilehto, 2006

GABIM PAS GABIMI, Analizë mbi gabimet e panumërta dhe të vazhdueshme në trashëgiminë kulturore", EC Ma Ndryshe për Forumin 2015

Konventa për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkitekturale të Evropës, PDKK, 2010

Udhëzues për Trashëgiminë Kulturore, PCDK, 2012

Plani Urbanistik Detal për Zonën Zejtare të miratuar në vitin 1978, Komuna e Prishtinës

Generalni Urbanistički Plan Prištine do 2000 godine, Skupština Opštine Priština, 1987

Stari Balkanski Gradovi, Branislav Kojic, 1977

"Qendra Historike" e Prishtinës numëron ditët e fundit, Raport Preliminar, EC Ma Ndryshe, Mars 2014

Qendra Historike e Prishtinës, Thirrje për konservim, Gjejlane Hoxha, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, Shtator 2011

Origjinat e urbanistikes moderne, Leonardo Benevolo, DITURIA, 2011

### Intervistat

Gjejlane Hoxha, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore

Shqipe Nixha, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës

Vjollca Aliu, Drejtorja për Trashëgimi Kulturore; Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit

Avni Manaj, Promovimi i Diversitetit Kulturor në Kosovë; Bashkësia Evropiane-Këshilli i Evropës

Luan Nushi, Insituti për Planifikim Hapësinorë; Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Festa Nela, Insituti për Planifikim Hapësinorë; Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Burbuqe Hydaverdi, Drejtorja për Urbanizëm; Komuna e Prishtinës

Burbuqe Deva, Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore

Rexhep Vula, arkitekt i pavarur

Sali Shoshi, CHwB, zyra në Kosovë

Valbona Saliuka, Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore

Agim Gërguri, Insituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës

Gani Gashi, Insituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës

Haxhi Mehmetaj, Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore

## EC Ma Ndryshe

Organizata jo-qeveritare EC Ma Ndryshe u themelua në mars të vitit 2006. Qëllimet kryesore të organizatës janë: promovimi i qytetarisë aktive dhe pjesëmarrëse dhe ngritja e vetëdijes qytetare për mbrojtjen dhe kultivimin e trashëgimisë kulturore. EC Ma Ndryshe është ndër themelueset dhe përfaqëson Kosovën në Rrjetin e Evropës Juglindore të organizatave që merren me trashëgimi kulturore - SEE Heritage Network. Gjithashtu, është themeluese e Forumit të Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit, Rrjetit të Organizatave Kulturore të Prizrenit dhe Rrjetit të Organizatave të Pavarura të Kulturës në Kosovë - Forumi Kulturor. EC Ma Ndryshe, që nga themelimi më 2006 është duke ushtruar presion direkt ndaj qeverisë lokale të Prizrenit për t'i krijuar qasje shoqërisë civile dhe qytetarëve për bashkë vendimmarrje. Përveç pjesëmarrjes direkte në proceset e konsultimeve publike, EC Ma Ndryshe ka avokuar rregullisht për respektimin e obligimeve ligjore për konsultime publike, përfshirjen sa më të gjerë komunitare në konsultime publike dhe përfshirjen e shqetësimeve dhe kërkesave të komunitetit në dokumentet e politikave publike.

Projektet kryesore: Aktivizmi kulturor dhe urban në Prizren (2014 - 2015), Lidhja e komunitetit me shërbyesit e drejtësisë (2014), Urbanism Watch - Urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm (2013 - 2014), Pjesëmarrja qytetare përmes medias sociale në Prizren dhe Gjilan (2013 - 2014), Qyteti gjithëpërfshirës - planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren (2013 - 2015), Trashëgimia kulturore, shtyllë qendrore për zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe rajonal në Prizren (2013 - 2014), Vullnetarët e Kulturës (2012 - 2013), Pjesëmarrja qytetare në hartimin dhe zbatimin e politikave kulturore në komunën e Prizrenit (2012 - 2013), Transparenca online e komunës së Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës (2012 - 2014), Roli i shoqërisë civile në promovimin e trashëgimisë kulturore (projekt rajonal) 2011 - 2013, Një përrallë ballkanike, trashëgimia otomane në Ballkan (projekt rajonal) (2011 - 2013), Ngritja e vetëdijes kulturore tek të rinjtë përmes dokumentarëve (2010), Forcimi i veprimit qytetar për promovim dhe mbrojtje të trashëgimisë kulturore (2009), Platforma "Culture 2013" (2008 - 2009), Kampet e Restaurimit (2007, 2008 & 2009), Forumet e Hapura Qytetare (2007), Ditët e Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2006, 2007 & 2008), Zambaku i Prizrenit 2006.

Publikimet: Ku është kalldrëmi i Prizrenit? (2014), Paraja publike si "paret e babës" (2014), Rinia dhe Transparenca: Përparim apo stagnim? (2014), Dokumentari - Sa aktiv, aq transparent? (2014), Udhëzues për Transparencën në Komuna (2014), Ligjet nuk po e mbrojnë Qendrën Historike (2014), Urbanizmi si lexim i qytetit (2014), Qendra Historike e Prizrenit-zonë e (pa)mbrojtur (2014), Qyteti gjithëpërfshirës (2014), Kush mbikëqyr mbikëqyrësit - llogaridhënia e shoqërisë civile në Kosovë (2013), Rinia dhe Transparenca: Të përjashtuar apo të injoruar? (2013), Planifikimi Urban për Qytetarët (2013), Pjesëmarrja qytetare në hartimin e politikave kulturore në Prizren (2013), Prizreni "Qytet i kulturës" - film dokumentar (2013), Gabim pas gabimi - analizë mbi gabimet e panumërta dhe të vazhdueshme në trashëgimi kulturore (2013), Pesë analiza të projektit "Online Trasparenca": 1. Një vit monitorim për më shumë transparencë 2. Degradimi Natyror dhe Urbanistik, 3. Respektimi i ligjit në qeverisjen lokale, 4. Qeverisja e mirë nuk është fjalë goje, 5. Transparenca e qeverisjes lokale në Prizren (2012 - 2013), Silent Balkan, film dokumentar i projektit "A Balkan Tale" (2012), Jeta kulturore në komunën e Prizrenit (në bashkëpunim me Teatrin ODA) (2010-2011), Prizreni në Retrovizorë, krahasim i fotografive të vjetra dhe të reja të Prizrenit (2009), Vullnetarizmi dhe Trashëgimia Kulturore (2009), Intervenimi me kosto të ultë (2009), Dokument Strategjik mbi Organizimin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2008), Trashëgimia Kulturore dhe Turizmi Kulturor në Prizren (2008), Hapësirat Kulturore në Kosovë (në bashkëpunim me Teatrin ODA) (2008).